

## Legjionaret/ Bakaj shenon ne Kupa e Ukraines

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 25 Shtator 2013 22:14

---



Elis Bakaj është rikthyer me gol tek skuadra e Cernomorets Odesa. Sulmuesi shqiptar, i harruar nga De Biazi në ndeshjet e fundit për shkak edhe të një dëmtimi që e ka shoqëruar, ka shënuar në fitoren 4-0 që ekipi i tij ka marrë në Kupë. Bakaj shënoi që në minutën e parë duke i dhënë avantazhin skuadres së tij dhe hapur serinë e golave të shënuar. Tani sulmuesi shqiptar pritet të rikthehet titullar tek Odesa edhe në ndeshjet e kampionatit por dhe ato në Europa League.